

ANKIM ADMINISTRATIV

drejtuar: Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

TIRANË

ANKIMUES: Instituti Shqiptar i Shkencave, organizatë jofitimprurëse e regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 3048, datë 28.03.2011, përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive Aranita BRAHAJ, me adresë: Rruga “Asim Vokshi”, Pallati 13/25, Kati 3 Tiranë dhe me email: aranita.brahaj@ais.al

KUNDËR: Vendimit nr. 457, datë 01.10.2021 të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet.

BAZA LIGJORE: Neni 21, pika 1, shkronja “b”, neni 123/3, neni 124/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Në datën 31.05. 2021 Instituti Shqiptar i Shkencave ka paraqitur një denoncim pranë Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet duke pretenduar shkelje të legjislacionit në fuqi që ndalon përdorimin e burimeve/aseteve të administratës shtetërore qendrore dhe vendore në mënyrë të padrejtë nga mazhoranca qeverisëse, në nivel qëndror dhe vendor në Durrës, në zgjedhjet e mbajtura në datën 25 prill 2021. Në përfundim të procedurës administrative Komisioneri ka miratuar vendimin nr. 457, datë 01.10.2021, i cili i është njoftuar kallëzuesit në datën 11 tetor 2021 përmes emailit zyrtar.

Duke e konsideruar këtë vendim të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet të pa bazuar në ligj dhe në prova, si dhe në kundërshtim me praktikën e deritanishme të zhvilluar nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, paraqesim këtë ankim administrativ.

I.

Shkelje e procesit të rregullt ligjor gjatë procedurës administrative

1. Instituti Shqiptar i Shkencave (*në vijim AIS*) është një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 3048, datë 28.03.2011 dhe ka për objekt të veprimtarisë së tij, ndër të tjera, zbatimin e legjislacionit zgjedhor në Republikën e Shqipërisë dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare për zgjedhjet në vend. Një ndër fushat kryesore të aktivitetit të AIS janë çështjet e financimit fushatave zgjedhore dhe, më specifikisht, të mospërdorimit të burimeve dhe aseteve të shtetërore në zgjedhje në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin dhe/ose standardet më të mira ndërkombëtare.¹
2. Në mbështetje të nenit 92/5 të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit të KQZ-së nr. 09, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrative të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” AIS ka paraqitur në KQZ me shkresë data 31.05.2021, protokolluar Nr 5613 prot. datë 03.06.2021, denoncim administrativ, duke vlerësuar se ka shkelje të legjislacionit në fuqi që ndalon përdorimin e burimeve / aseteve të administratës shtetërore qendrore dhe vendore në mënyrë të padrejtë nga mazhoranca qeverisëse, në nivel qendror dhe vendor në Durrës, në zgjedhjet e mbajtura në datën 25 prill 2021.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (*në vijim Komisioneri*) në datën 16.07.2021, i është drejtuar Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Bashkisë Durrës, duke ju kërkuar një informacion të detajuar sqarues për sa pretendohet në këtë denoncim.
4. Duke mos pasur përgjigje prej Bashkisë Durrës dhe Këshillit të Ministrave dhe duke e vlerësuar të rëndësishëm për hetimin administrativ informacionin e kërkuar, Komisioneri me vendimin nr. 439, datë 02.08.2021 ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ ndaj Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Bashkiak Durrës. Ky vendim i ndërmjetëm i është njoftuar AIS me postim dokumenti zyrtar, dorëzuar nga postieri më 19. 08. 2021.
5. Edhe pas zgjatjes së afatit të shqyrtimit administrativ Komisioneri ka administruar në datën 02.08.2021 vetëm përgjigjen e Bashkisë Durrës prej znj. Emeriana Sako, që kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë Durrës. Rezulton se Këshilli i Ministrave nuk i ka kthyer përgjigje Komisionerit dhe ky i fundit nuk ka kërkuar më përgjigje prej tyre,

¹ Shih për më tepër <http://ais.al/new/>

por edhe në zbatim të nenit 169 të Kodit Zgjedhor² nuk ka vendosur asnjë masë ndëshkimore për mosbashkëpunim me KQZ-në.

6. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr. 107, datë 26 korrik 2021 (por edhe me vendimin nr. 108, datë 26 korrik 2021) ka vendosur:

“5. Neni 81, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative përcakton se “*organi kompetent kërkon dhe njihet me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara nga ligji*”. Në rastin konkret rezulton se KSHZ është mjaftuar vetëm me shkëmbimin e korrespondencës me Bashkinë e Tiranës, administratoren e njësisë administrative nr. 10 zj. KK, pa hetuar më shumë për të mbledhur prova dhe fakte që do të vërtetonin shkeljen ose jo të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. KAS për këtë arsye konstaton se hetimi i kryer nga ana e KSHZ nuk është i plotë dhe i gjithanshëm, pasi nuk janë shteruar të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore për të siguruar provat dhe faktet e nevojshme për çështjen.

6. Referuar nenit 93 të Kodit të Procedurave Administrative, *pas përfundimit të procedurës hetimore, (...) palët e interesuara kanë të drejtë të shprehen përpara marrjes së vendimit përfundimtar*. Si palë e interesuar në procedimin administrativ ka të drejtë të marrë pjesë çdokush që ka interes të ligjshëm, bazuar në nenin 44, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative. KAS çmon se subjekti ankues, Organizata “Qëndresa Qytetare” shfaq një interes të ligjshëm në këtë procedim duke qenë dhe kallëzuesi i denoncimit dhe për këtë arsye duhej thirrur si palë e interesuar në procedimin administrativ të ndjekur nga KSHZ.

7. KAS çmon se respektimi i të drejtave dhe garancive procedurale të palëve pjesëmarrëse në procesin administrativ, ka rëndësi vendimtare për respektimin e procesit të rregullt ligjor.

Për këto arsye KAS, i cili në këtë fazë të procesit nuk ka marrë në analizë ligjshmërinë e argumenteve të KSHZ përse i përket themelit të çështjes, vlerëson që ky i fundit duhet t’u japë mundësinë palëve të njihen dhe të përballen me to.”

7. AIS:

- nuk është vënë në dijeni dhe nuk ka pasur mundësi të shprehet për asnjë material/përgjigje që është depozituar nga Bashkia Durrës.
- Këshilli i Ministrave dy herë nuk është shprehur në lidhje me këtë denoncim, nuk ka ofruar bashkëpunim me Komisionerin dhe nuk është ndërkohë administrativisht për qëndrimin e mbajtur prej tij.

² Neni 169 i Kodit Zgjedhor parashikon se: “*Refuzimi për të bashkëpunuar me KQZ-në ose për të dhënë informacione që parashikohen nga ky Kod KQZ-së, nga ana e zyrtarëve të organeve të qeverisjes vendore ose qendrore, ndëshkohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë.*”

- si subjekti ankues, AIS shfaq një interes të ligjshëm në këtë procedim duke qenë se është kallëzuesi i denoncimit dhe për këtë arsye duhej thirrur si palë e interesuar në procedimin administrativ të ndjekur nga Komisioneri.
- në procesin e marrjes së vendimit përfundimtar AIS nuk i është dhënë mundësia e parashikuar nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 93, për t'u shprehur përfundimisht për pretendimet e saj.

Për sa më sipër procedura administrative e ndjekur nga Komisioneri në lidhje me denoncimin e AIS ka shkelje të procesit të rregullt ligjor.

II.

Themeli i kërkesës së AIS mbeti pa përgjigje

8. Komisioneri në vendimin e tij nr. 457, datë 01.10.2021 është shprehur se: *“Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi denoncimin vlerëson se duhet të nxjerrë jashtë kompetencës, kërkesat e kallëzuesit në lidhje me pretendimet se miratimi i listave të përfituesve pa verifikim statusin “emergjence në strehim” dhe “nevojë për ndihmë”, favorizim në ndryshimin e statusit dhe nivelit të përfitimit nga DS1 në DS2 dhe DS3 për disa individë, si dhe abuzimi me mosvlerësim të nevojës për ndihmë sipas emergjencës dhe gjendjes vulnerabël. KQZ nuk është organi kompetent për të vlerësuar dëmin ekonomik, që mund të jetë shkaktuar nga mosvlerësimi i saktë i pretenduar nga denoncuesi.”*

9. Sipas Raportit Përfundimtar të ODIHR për zgjedhjet e mbajtura në 25 prill 2021: *“Media raportoi se pati një rritje të madhe në shpërndarjen e granteve nga bashkitë, miratuar javën para zgjedhjeve sipas programit përkatës të rindërtimit. Për shumë përfitues grantesh ka pasur gjithashtu një rritje të vlerës së shpërblimeve në cash të autorizuar nga bashkia. Disa bashkëbisedues të MkvZ-së së ODIHR-it i perceptuan këto shpërndarje grantesh si shpërdorim të burimeve shtetërore. MkvZ-ja e ODIHR-it mori edhe raportime të tjera, sipas së cilave u bënë përpjekje për të ndikuar në votim përmes sigurimit të stimujve, të tilla si lëshimi i lejeve që vërtetojnë ndërtimet e paligjshme. Këto raporte gjithashtu pretendonin se shumë nëpunës civilë, një grup i prekshëm nga presioni, ishin inkurajuar të votonin për partinë në pushtet.*

Organet e zbatimit të ligjit duhet të hetojnë të gjitha pretendimet për shkelje zgjedhore, përfshirë shpërdorimin e burimeve shtetërore, në mënyrë të plotë, në kohë dhe në mënyrë transparente. Votuesit duhet të informohen sistematikisht në lidhje me mekanizmat e

zbatueshëm për të raportuar çdo rast presioni dhe për të qenë të sigurt se nuk do të përballen me pasoja negative.”³

10. AIS në denoncimin e saj nuk i ka kërkuar Komisionerit të vlerësojë dëmin ekonomik të çfarëdolloj situatë të kundërligjshme. Në të kundërt të asaj që pretendohet, denoncimi nuk ka si objekt faktin nëse ka ose jo dëm ekonomik, por nëse procedurat e ndjekura nga Këshilli i Ministrave dhe Këshilli Bashkiak Durrës janë në përputhje me legjislacion në fuqi, dhe nëse respektojnë posaçërisht parimin ligjor të ndalimit të përdorimit të burimeve/aseteve të administratës shtetërore qendrore dhe vendore në mënyrë të padrejtë dhe/ose krijimin e një avantazhi të padrejtë elektoral në favor të një subjekti zgjedhor. AIS ka kërkuar hetimin administrativ për të konfirmuar ose jo zbatimin e drejtë të legjislacionit në fuqi, në të gjithë rregullat procedurale të tij nëse ka apo jo abuzivizëm në këndvështrimin elektoral, për periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve nga ana e Këshillit të Ministrave dhe Bashkisë së Durrësit. Pikërisht për këtë gjë është krijuar dhe ka detyrë ligjore të kryejë KQZ. Mungesa e zbatimit të drejtë të procedurave, abuzivizmi i mundshëm në vendimarrje, apo qoftë edhe një statistikë e thjeshtë financimi e periudhës para zgjedhore dhe pas zgjedhore duhet të jenë, ndër të tjera, objekt i hetimit administrativ të Komisionerit dhe të konkluzionit nëse ka apo përdorim të padrejtë të burimeve/aseteve shtetërore në fushatë dhe 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Për këtë objekt të denoncimit nuk është kryer asnjë hetim administrativ, e theksojmë nën këndvështrimin e parimit të ndalimit të burimeve/aseteve shtetërore 4 muaj para datës së zgjedhjeve dhe në funksion të garës së drejtë zgjedhore. Për pasojë, ky pretendim i kallëzuesit ka mbetur pa përgjigje nga KQZ.

11. Komisioneri në vendimin e tij nr. 457, datë 01.10.2021 është shprehur se: *“Nga provat e vëna në dispozicion dhe argumentat e dhëna nga kallëzuesi Komisioneri vlerëson se nuk është në kompetencë të tij të vlerësojë ligjshmërinë e akteve të Këshillit të Ministrave apo vendimeve të këshillit bashkiak Durrës, dalë për zbatimin e tyre.”* AIS e ka të pamundur të gjejë në tekstin e këtij konkluzioni të Komisionerit arsyetimin se pse është arritur në këtë përfundim. AIS nuk i ka kërkuar Komisionerit të shfuqizojë ndonjë vendim të Këshillit të Ministrave dhe të Këshillit Bashkiak Durrës, sepse natyrshëm Komisioneri nuk e ka një kompetencë të tillë. Nga ana tjetër, ky qëndrim i Komisionerit nuk është në zbatim të detyrimit të tij ligjor për hetimin administrativ të shpërdoirmit të burimeve/aseteve shtetërore në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve dhe deri në datën e zgjedhjeve. Sipas nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe të Vendimit nr. 09 *Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet*

³ <https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>

që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.

12. Në rast se Kuvendi, për shembull 2 muaj para datës së zgjedhjeve, miraton një ligj që ul taksën e Tatimit për Vlerën e Shtuar, a ka kompetencë Komisioneri të hetojë administrativisht dhe të konstatojë se Kuvendi në mënyrë të kundërligjshme ka marrë një vendim që përbën abuzivizëm me burimet/asetet shtetërore dhe ka shkelur standardet e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme? Përgjigjja është natyrisht që PO. Në një rast të tillë a do të mund të thotë Komisioneri se nuk është kompetencë e tij të vlerësojë *ligjshmërinë e ligjit të miratuar nga Kuvendi* për uljen e Tatimit të Vlerës së Shtuar, 2 muaj para datës së zgjedhjeve? Përgjigjja është natyrisht JO.

As më shumë dhe as më pak AIS ka paraqitur një situatë e tillë para Komisionerit për vendimmarrje, gjë e cila ka munguar prej tij.

13. Sa më sipër kërkojmë nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve:

A. Shfuqizimin e vendimit nr. 457, datë 01.10.2021 të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim tek Komisioneri.

ose

B. Në mbështetje të nenit 137 dhe/ose nenit 138 të Kodit të Procedurave Administrative ndryshimin e vendimit nr. 457, datë 01.10.2021 të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet dhe kryerjen e hetimit administrativ shtesë të denoncimit të AIS nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe marrjen e masave ligjore në përfundim të tij.

Me konsideratë,

Aranita BRAHAJ

Drejtoresha Ekzekutive

Bashkëlidhur po ju paraqesim:

- Vendimin nr. 457, datë 01.10.2021 të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet.
- Denoncimin e paraqitur nga AIS tek Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet.